STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 18 dhjetor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON NDIHME PER TAKSAT DHE MBESHTETJE PER BANORET E NJU JORKUT (NEW YORKERS) TE PREKUR NGA URAGANI SENDI (SANDY)

Departamenti Shtetëror i Taksave (State Tax Department) miraton masa për të mbuluar dokumentacionin me vonesë dhe për të siguruar mbështetje për bizneset

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot një sërë masash të ndihmës për taksat për banorët e Nju Jorkut (New Yorkers) që ende po rimëkëmben nga Uragani Sendi (Sandy). Sipas masave të reja të përmbledhura nga Guvernatori, banorëve të Nju Jorkut (New Yorkers) të prekur nga stuhia do t'u konsiderohet dokumentacioni i tyre i taksave si i paraqitur në kohë edhe nëse e paraqesin me vonesë, bizneset e rivendosura përkohësisht në Nju Jork (New York) për të ndihmuar me përpjekjet e rimëkëmbjes nuk do të duhet të paguajnë disa taksa shtetërore dhe punonjësve do t'u jepet një përjashtim nga taksa për vlerën e lejes që dhurojnë për përpjekjet e ndihmës të Uraganit Sendi (Sandy).

"Jemi duke dhënë mbështetje dhe ndihmë për taksat për shumë banorët e Nju Jorkut (New Yorkers) që janë ende duke rindërtuar pas shkatërrimit të pashembullt të Uraganit Sendi (Sandy)," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Këto dispozita do të ndihmojnë individët dhe bizneset e prekura, si dhe shumë nga ata që po sigurojnë ndihmë për banorët e Nju Jorkut (New Yorkers) gjatë kësaj kohe rimëkëmbje."

Udhëzimet dhe hollësitë mbi kualifikimin për secilën nga këto dispozita të ndihmës mund të gjenden në faqen në internet të Departamentit Shtetëror të Taksave (State Tax Department) Ndihma për taksat e Uraganit Sendi (Sandy).

Dokumentacioni me vonesë

Departamenti i Taksave do t'a trajtojë dokumentacionin dhe pagesat që janë me vonesë për shkak të Uraganit Sendi (Sandy) si të paraqitura në kohë – dhe ato nuk do të jenë subjekt i ndëshkimeve dhe interesave.

Procesi është shumë i thjeshtë për taksapaguesit e prekur. Kur përdoruesit e internetit fillojnë të plotësojnë dokumentacionin e tyre, do t'u kërkohet nëse është me vonesë ose i paplotë për taksat e mëposhtme: taksën e shitjeve, taksën e përdorimit të autostradave, taksën e lëvizjes të udhëtarit të

transportit metropolitan dhe taksa e mbajtjes (Formulari NYS-45). Përdoruesit e formularëve prej letre thjesht duhet të shkruajnë "Hurricane Sandy" në pjesën e sipërme të dokumentacionit me shkronja të mëdha.

Rivendosja e përkohëshme

Bizneset dhe individët që rivendosen në Shtet përkohësisht si rezultat i stuhisë nuk do t'u vlerësohen taksa të korporatës, taksa të mbajtjes dhe taksa të të ardhurave personale. Zakonisht, taksat do të shkaktohen nga lidhjet e korporatave dhe/ose punonjësit e vendosur në Nju Jork (New York). Praktika mbulon periudhën nga 26 tetori deri më 31 dhjetor 2012.

Dhurimi i lejes

Kur punëdhënësit përdorin një Program të Dhurimit të Lejes të miratuar, punonjësit mund të heqin dorë nga leja e pushimeve, e sëmundjes ose personale në shkëmbim të pagesave në para për organizata të caktuara të përjashtuara nga taksat të përfshira në përpjekjen e ndihmës të Sendit (Sandy). Punonjësve nuk u kërkohet të përfshijnë pagesa të tilla për qëllime të taksave të të ardhurave. Praktika zbatohet për pagesat e bëra përpara 1 janarit 2014 dhe përputhet me rregulloret federale të nxjerra nga IRS (Njoftimi 2012-69 i IRS).

Më shumë informacion:

- Vizitoni www.tax.ny.gov
- Ndiqni Departamentin e Taksave në Twitter dhe YouTube

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418